

1. Informacion Bazë

- Viti i Themelimit: 2021
- Statusi Ligjor: [Organizatë joqeveritare]
- Selia Qendrore: [Rr Fadil Rada, Njesia Bashkiake 2, Tirane, Shqiperi]
- Faqja e Internetit: [www.futural.org]
- Email kryesor i organizatës: [ngofutura@gmail.com]
- Telefoni kryesor i organizatës: [0699702214]

2. Misioni

Të promovojë dhe zbatojë mekanizma të qëndrueshëm të shoqërisë në drejtim të rritjes së kapaciteteve dhe nxitjes së aktivizmit. Qendra synon të stimulojë dhe të mbështesë kërkime dhe ndërhyrje cilësore mbi çështje të rëndësishme të politikave publike.

3. Vizioni (Opsionale)

Të jetë një qendër reference për fuqizimin e qytetarëve dhe aktorëve të shoqërisë në ndërtimin e një shoqërie të përfshirë, aktive dhe të informuar, përmes zhvillimit të kapaciteteve, promovimit të aktivizmit dhe mbështetjes së politikave publike të bazuara në kërkime dhe ndërhyrje cilësore.

4. Fushat Kryesore të Fokusit

Një listë ose përshkrim i shkurtër i sektorëve ose fushave kryesore të punës së organizatës. Për shembull:

- Mbrojtja e Mjedisit
- Rritja e kapaciteteve të rinjve, vajzave dhe grave
- Mbështetja, promovimi, ndërgjegjësimi në komunitet
- Advokimi

5. Aktivitetet/Programet Kryesore

Një përshkrim i shkurtër i projekteve, nismave ose programeve kryesore që organizata zhvillon ose ka zhvilluar:

Projekti “Albanian Experience”, pati si qëllim promovimin e thesareve natyrore dhe kulturore të Shqipërisë përmes një qasjeje novatore dhe tërheqëse. U fokusua në dy zona të jashtëzakonshme: Klasterin Bregdetar Adriatik (Shkodër–Theth) dhe Klasterin e Jugut të Brendshëm (Berat & Gjirokastrë). Përmes dokumentarëve impresionues, eventeve të kuruara dhe një strategjie të freskët promovimi, projekti solli në vëmendje peizazhet e mbrojtura malore, biodiversitetin e pasur dhe autenticitetin e jetës rurale shqiptare. U theksua rëndësia e ruajtjes së mjedisit dhe promovimit të turizmit të qëndrueshëm, duke e trajtuar natyrën jo thjesht si

atraksion turistik, por si pasuri që kërkon mbrojtje dhe menaxhim të përgjegjshëm. Komunitetet lokale dhe veçanërisht gratë, u përfshinë aktivisht në ngjarjet e organizuara, duke nxitur ndërgjegjësimin për vlerat e trashëgimisë natyrore dhe kulturore.

Projekti “Your Health, Your Choice! Do it Right”, i mbështetur nga Slovak Aid dhe Ambasada e Sllovakisë në Shqipëri, u përqendrua në ndërgjegjësimin e të rinjve dhe komunitetit mbi lidhjen mes shëndetit individual, zgjedhjeve të përditshme dhe cilësisë së mjedisit. U organizuan një sërë aktivitete edukative dhe informuese në shkolla të mesme në Tiranë, me qëllim nxitjen e stilit të jetesës së shëndetshme, mbrojtjes së mjedisit dhe parandalimit të sëmundjeve të lidhura me ndotjen. Të rinjtë u përfshinë në trajnime interaktive mbi ushqimin e shëndetshëm, ndotjen e ajrit, menaxhimin e mbetjeve dhe rolin e tyre si qytetarë aktivë në ruajtjen e mjedisit. U krijuan materiale informuese dhe u zhvilluan sesione informimi me mjekë dhe ekspertë të shëndetit publik. Projekti nxiti një frymë të re reflektimi të të rinjtë mbi zgjedhjet që bëjnë çdo ditë dhe ndikimin që ato kanë në mirëqenien personale dhe kolektive. Si rezultat, mbi 200 të rinj morën pjesë në aktivitetet e zhvilluara, duke përçuar mesazhe të qarta për një jetë më të shëndetshme dhe një mjedis më të pastër.

Projekti “Podcast Caravan – Artist Stafetë”, i mbështetur nga Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri (IPA/2020/421-822), solli një format inovativ ndërveprimi me të rinjtë dhe komunitetin përmes artit dhe formateve të medias së re. Përmes një karvani audio-podcastesh të regjistruara në terren dhe të transmetuara online, u adresuan tema që lidhen me mjedisin, pjesëmarrjen qytetare dhe të drejtat sociale, duke u dhënë zë të rinjve dhe aktivistëve lokalë në zona të ndryshme të Shqipërisë. Në vijim të këtij cikli, u realizua edhe “Cikli i Pogradecit”, si pjesë e nismës Artist Stafetë, me mbështetje nga Delegacioni i BE-së në Shqipëri. Ky komponent u fokusua në qytetin e Pogradecit dhe përfshiu të rinj, artistë lokalë dhe aktivistë që përdorën formate artistike, si performanca në hapësira publike, video, instalacione dhe diskutime, për të trajtuar çështje mjedisore dhe sociale me rëndësi për komunitetin lokal. Projekti solli një formë të re ndërgjegjësimi dhe aktivizmi në qytet, duke e kthyer artin në një mjet për dialog publik dhe përfshirje qytetare.

Projekti “Inspire Change”, i mbështetur nga SIDA dhe Regional Civil Society Development Hub, u zhvillua me qëllim rritjen e ndërgjegjësimin dhe edukimin e publikut, veçanërisht të rinjve, mbi dhunën ndaj grave dhe vajzave, përmes artit si mjet transformues. Përmes performancave artistike dhe ndërveprimit publik, projekti solli në vëmendje përvojat e përbashkëta të Shqipërisë dhe Kosovës në trajtimin e kësaj dukurie, duke i dhënë zë të rinjve, aktivistëve dhe komuniteteve për të reflektuar e vepruar ndaj padrejtësive gjinore. Aktivitetet nxorën në pah rolin e artit në sfidimin e normave patriarkale dhe krijimin e hapësirave për dialog gjithëpërfshirës. Në të njëjtën linjë u zhvillua edhe projekti “Positive Role Models Challenging the Stereotypes”, i mbështetur nga Rrjeti për Fuqizimin e Grave Shqiptare. Ky projekt pati si synim ndryshimin e perceptimeve shoqërore dhe zbehjen e stereotipeve gjinore përmes promovimit të figurave

Qendra FuturAL

pozitive që guxojnë të flasin, të ndërveprojnë dhe të nxisin ndryshime reale. Përmes diskutimeve publike dhe formateve të angazhimit komunitar, u inkurajua mendimi kritik dhe mbështetja për një shoqëri që përfshin, pranon dhe fuqizon të gjithë individët, veçanërisht vajzat dhe grate, në adresimin e pritshmërive dhe sfidave sociale. Projekti synoi të ndikojë në një transformim afatgjatë të mentalitetit dhe të kulturës së heshtjes, përmes fuqizimit të zërave që sfidojnë status quone.

6. Shtrirja Gjeografike

Organizata operon në qarkun Tiranë dhe në qarkun Korçë, aty ku ka zbatuar një pjesë të rëndësishme dhe më të madhe të projekteve. Por fale bashkëpunimeve të ndryshme jemi shtrirë në të gjithë vendin.

7. Udhëheqja

Drejtori Ekzekutiv/CEO: [Doralda Tanellari]

8. Partneritetet dhe Bashkëpunimet (Opsionale)

"Donatorët kanë qenë Bashkimi Evropian, Ambasada e Vendeve të Ulëta, Ambasada Sllovaqe, Rrjeti AWEN, SIDA dhe Regional Civil Society Development Hub, Bashkia Tiranë dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit."

9. Ndikimi (Opsionale)

Theksoni ndonjë rezultat të matshëm, statistika, ose arritje të rëndësishme.

Më shumë se 1000 persona, përfshirë aktivisht, në aktivitete të ndryshme të FuturAL.

10. Lajmet e Fundit/Çmimet (Opsionale)

- Projekti "Inspire Change" u vlerësua si një ndër projektet me të mira duke zhvilluar dhe një dalje ne radio dhe shpjegim me detaje te tij nga drejtoresha Ekzekutive e organizatës.